

URDHËR
Nr.566, datë 23.11.2011

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL”,
TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR XHUVANI” ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, të programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Marketing”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “Marketing”.

2. Programi i studimit të ciklit të dytë “Master profesional” realizohet me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik.

3. Programi i studimit të fillojë në vitin akademik 2011-2012 dhe brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri të ketë plotësuar kushte, bashkëngjitur.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj